



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 585/13 prot.

Datë 10.04.2025

V E N D I M

Nr. 477/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-20964-09-20-2024, me objekt: “Blerje Lëfterake elektrike për Terminalin e Autove”, me fond limit 20.000.000 (njëzet milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK me NIPT L21616501N dhe adresë Fshati Vrin, Rruga Vath Turja, Komuna Rrashbull.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës me adresë Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Subjekte të interesuara:

“AON” SHPK me NIPT L71402044K dhe adresë Godine me nr. pasurie 135/4, zona kadastrale 2119, Autostrada Tirane-Durres Km. 9, Kashar, Tirane.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.09.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-20964-09-20-2024, me objekt: “Blerje Lefterake elektrike për Terminalin e Autove”, me fond limit 20.000.000 (njëzet milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 11.11.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 13.12.2024 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|--|--------------------|---------------|
| 1. "AON " | 17,400,000.00 lekë | I kualifikuar |
| 2. EMC ENGINEERING
MAINTENANCE CENTER | 17,305,712.00 lekë | Skualifikuar |

II.4. Në datën 08.01.2025 është publikuar “Njoftim i Fituesit” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 1, datë 13.01.2025, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “AON” Shpk.

II.5. Në datën 15.01.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/4986 dhe me nr. 144/2025 prot., datë 15.01.2025 e operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 144/1 prot., datë 16.01.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK.

II.7. Autoriteti Kontraktor ka dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave informacion mbi trajtimin e ankesë së ankimuesit, protokolluar me tonën me nr. 144/2 prot., datë 21.01.2025 ku ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor **nuk e ka pranuar**, ankesën.

II.8. Autoriteti Kontraktor ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 152 prot., datë 21.01.2025, informacion mbi trajtimin e ankesë së ankimuesit, protokolluar me tonën me nr. 144/3 prot., datë 23.01.2025 ku ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor **nuk e ka pranuar** ankesën.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.10. Në datën 30.01.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 152/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-20964-09-20-2024, me objekt: “Blerje Lifterake elektrike për Terminalin e Autove”, me fond limit 20.000.000 (njëzet milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Me shkresën nr. 478 prot., datë 10.02.2025, protokolluar me tonën nr. 144/8 prot., datë 12.02.2025, autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 152/2025, datë 30.01.2025, si vijon: “...Autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 152/2025 prot., datë 30.01.2025 të KPP_së, duke bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar në SPE dhe duke pasqyruar arsyen e skualifikimit të OE “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK sipas procesverbalit bashkëlidhur”.
-procesverbal me datë 07.02.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

II.12. Në datën 13.02.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 234/2025 ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-20964-09-20-2024, me objekt: “Blerje Lifterake elektrike për Terminalin e Autove”, me fond limit 20.000.000 (njëzet milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

II.13. Në datën 27.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me

numër ankimi elektronik A/2025/5094 dhe me nr. 585/2025 prot., datë 28.02.2025 e operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.14. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 585/1 prot., datë 01.03.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK.

II.15. Autoriteti Kontraktor ka dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave informacion mbi trajtimin e ankesë së ankimuesit, protokolluar me tonën me nr. 585/2 prot., datë 06.03.2025 ku ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor **nuk e ka pranuar**, ankesën.

II.16. Autoriteti Kontraktor ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 731 prot., datë 06.03.2025, informacion mbi trajtimin e ankesë së ankimuesit, protokolluar me tonën me nr. 585/3 prot., datë 10.03.2025 ku ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor **nuk e ka pranuar** ankesën.

II.17. Nga shyrtimi i ankesës rezulton, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-se mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, në mjediset e institucionit tonë, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtarë të njësisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, të cilët ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për këtë qëllim iu drejtua me shkresën nr. 585/4 prot., datë 18.03.2025 operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK dhe autoritetit kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, për t’u paraqitur në seancë dëgjimore pranë ambienteve të KPP-së, ditën e premte, datë 21.03.2025 ora 10:00.

II.18. Me shkresën nr. 856/1 prot., datë 25.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 585/6 rpot., datë 28.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje Njoftimit nr. 585/4 prot., datë 18.03.2025”, autoritetit kontraktor, Autoriteti Portual Durrës ka njoftuar që nuk mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore për shkak se ka marrë dijeni me vonesë.

II.19. Me shkresën nr. 585/5 prot., datë 25.03.2025 operatorit ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK dhe autoritetit kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, për t’u paraqitur në seancë dëgjimore pranë ambienteve të KPP-së, ditën e premte, datë 28.03.2025 ora 10:00.

II.20. Në seancën dëgjimore të datës 28.03.2025 të zhvilluar në mjediset e KPP-së në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqitën përfaqësuesit e operatorit ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” ShPK (Z. A. Ç., Z. H. K., Znj. O. D.,) dhe përfaqësues nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës (Z. L.M., Znj. E. R.). Përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues dhe të autoritetit kontraktor nuk kishin ndonjë kontestim gjatë seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore u regjistrua në audio.

II.21. Me shkresën me nr. 585/7 prot., datë 02.04.2025 dhe shkresën me nr. 585/8 prot., datë 02.04.2025 me objekt “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua kompanisë prodhuese Linde Material Handling.

II.22. Me shkresën nr. 585/9 prot., datë 02.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua palëve të interesuara që, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.23. Në adresën e email të institucionit të KPP-së, kompania prodhuese Linde Material Handling ka dërguar informacionin e kërkuar, protokolluar me tonën me nr. 585/10 prot., datë 09.04.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se:

“Mjeti i referuar nga OE ne oferten teknike ,bazuar ne manualin e prodhuesit nuk permbush kriteret e parametrave te specifikuara nga komisioni i specifikimeve teknikesi me poshte argumentimi:

- *Pika 10:Lartesia e ngritjes eshte kerkuar nga AK minimumi 3300 mm nderkohe qe sipas katalogut referuar ofertes teknike eshte 2900 mm.*

- *Pika 23:Numri i shkalleve eshte kerkuar nga AK 2-stage me free lift ose 3-stage me free lift nderkohe qe sipas katalogut dhe referuar ofertes teknike mjeti i ofruar eshte Standard Mast.*

- *Pika 24:Ngritja e thikave pa ngritur bigen(Free Lift) eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktor ne lartesine minimumi 1400 mm,por referuar katalogut sipas ofertes teknike verehet se modeli i ofruar ka free lift 150 mm. Ne piken 5 te Kriterëve te veçanta te kualifikimit kërkohet ne menyre qe te krahasohet pajtueshmëria dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.OE ka ngarkuar ne SPE dhe nje material te emërtuar si Specifikimet e Piruneve Elektrik por qe vihet re se nuk ka korrespondence mes katalogut dhe specifikave te deklaruarane.Ne kete menyre OE me dokumentacionin shtojce e ngarkuar ne SPE deklararon se: Lartesia e ngritjes se forkliftit eshte 4465 mm nderkohe qe kjo e dhene nuk ekziston ne asnje pjese te katalogut.Prodhuesi Linde i ka te mire deklauara te gjithë modelet 2-stage dhe 3-stage ne katalogun e tij dhe keto shifra te deklaruar nga OE nuk rezultojne askund duke e bere oferten e tij te pabesueshme dhe duke mos plotesuar piken 5 te kriterëve te vecanta te kualifikimit.Per te kuptuar dhe vleresuar kapacitetin teknik te OE do duhej qe KVO te mund te krahasoje specifikimet e katalogut me ato te kerkuara nga AK.Mbi kete baze AK rrit besueshmerine mbi kapacitetet teknike te OE.Gjithashtu OE ka deklaruar dhe disa specifika te tjera qe nuk korrespondojne dhe nuk gjenden ne asnje rresht te katalogut si:*

- *Lartesia max e mjetit me kolonen ulur: 2480 mm*

- *Ngritja e thikave pa ngritur bigen(Free Lift):Triplex Mast me 1425 mm Free Lift*

“EMC Engineering Maitenance Center” sh.p.k ka paraqitur me ane te nje tabele te plotësuar nga ai nje sere specifikimesh qe nuk gjenden ne katalogun e paraqitur duke marre kështu barrën e prodhuesit dhe duke mos paraqitur asnjë deklaratë te prodhuesit per mundësinë e prodhimit te nje forklifti me parametra te tilla. Ky vetdeklarim nuk mund te merret parasysh mbi kapacitetin teknik pasi bie ndesh me piken 4 dhe piken 5 te kriterëve te veçanta te kualifikimit.Keto te dhëna mbi specifikat e mjetit janë te pamiratuara nga kompania prodhuese dhe nuk gjenden ne asnjë katalog te kompanisë prodhuese Linde Material Handling.

Per sa me lart: -OE "EMC Engineering Maitenance Center" sh.p.k nuk ka arritur te përzgjedhë nga ana teknike forkliftin e duhur ne katalogun e prodhuesit duke dështuar ne ofertim dhe ne përmbushjen e kriterëve te veçanta te kualifikimit ose ka pretenduar te modifikoje nje forklift Standart Mast me Nr.serie 1254-01 ne nje forklift Triplex Mast.

-OE "EMC Engineering Maitenance Center" sh.p.k nuk përmbush specifikimet teknike ne dokumentat e dorëzuara dhe gjithashtu nuk e ka mbështetur ofertimin e tij ne manuale,katalogë apo skeda teknike te kompanisë prodhuese per pikat 10,23,24 te specifikimeve teknike te kërkuara nga AK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2, të modifikuar tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5:

”5.Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Dokumenti me emërtimin *Katalogu_Linde_EN_ds_e35_250_1254 pdf*;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit

kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve

teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.11. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin me emërtimin *Katalogu_Linde_EN_ds_e35_250_1254 pdf*, pretendon se:

1- Përsa i përket pretendimit të KSHA-së, sin ë vijim: *“Pika 10: Lartësia e ngritjes është kërkuar nga AK minimumi 3300 mm ndërkohë që sipas katalogut referuar ofertës teknike është 2900 mm.” sqarojmë si më poshtë vijon:*

Në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në dokumentin e emërtuar “5_Specifikime_Pirun_elektrik EMC”, është përcaktuar nga prodhuesi dhe nga ana jonë se për pajisjen “Lfterak elektrike” për modelin E50/600 HL, të serisë: “1254-01” , ku specifikim teknike është si më poshtë:

<i>10.Lartësia e ngritjes:Minimumi 3300 mm 4465 mm Triplex Mast h3 4465mm / h1 2480mm / h2 1425mm</i>
--

Në Shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit dhe konkretisht i përcaktuar në dokumentin e titulluar “6 Specifikime shqip.docx” të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar parametrin teknik nr.10 si në vijim:

<i>Lartësia e ngritjes:</i>	<i>Minimumi 3300 mm</i>
-----------------------------	-------------------------

Pra ne kemi ofruar modelin E50/600 HL, të serisë: “1254-01”, me 3 (tre) shkallë ku lartësia e ngritjes është “h3 4465 mm”, duke e plotësuar këtë parametër, pasi këtë parametër e kemi ofruar në nivel më të lartë se ai i kërkuar nga autoritetit kontraktor, pasi në autoriteti kontraktor këtë parametër e ka kërkuar në nivelin “minimum 3300 mm”, ndërkohë që ne e kemi ofruar në nivelin “h3 4465 mm”, pra rreth “1165 mm” më shumë.

PRA KY PRETENDIM I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE (DHE JO I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE) NUK QËNDRON.

2- Përsa i përket pretendimit të KSHA-së, si në vijim: “Pika 23: Numri i shkallëve është kërkuar nga AK 2-stage me free lift ose 3-stage me free lift ndërkohë që sipas katalogut dhe referuar ofertës teknike mjeti i ofruar është Standard Mast.” sqarojmë se nuk qëndron, pasi sikurse e kemi sqaruar më sipër ne i kemi ofruar autoritetit kontraktor modelin E50/600 HL, të serisë: “1254-01”, me 3 (tre) shkallë, fakt i cili vërtetohet dhe në dokumentin e emërtuar “5_Specifikime_Pirun_elektrik_EMC” ku është specifikuar si më poshtë:

23.	Numri i shkallëve:	2-Stage me Free Lift ose 3-Stage me Free Lift	Triplex me Free Lift
-----	--------------------	---	----------------------

PRA KY PRETENDIM I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE (DHE JO I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE) NUK QËNDRON.

3- Përsa i përket pretendimit të KSHA-së, si në vijim: “Pika 24: Ngritja e thikave pa ngritur bigen(Free Lift) është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në lartësinë minimumi 1400 mm, por referuar katalogut sipas ofertës teknike verëhet se modeli i ofruar ka free lift 150 mm.” sqarojmë si më poshtë vijon:

Në katalogun e dorëzuar nga ana jonë në dokumentin e emërtuar “5_Specifikime_Pirun_elektrik_EMC”, dhe ne dokumentin “OFERTA_APD_REF-20964-09-20-2024” është përcaktuar nga prodhuesi dhe nga ana jonë se për pajisjen “Lifterak elektrike” për modelin E50/600 HL, të serisë: “1254-01”, ku specifikim teknike është si më poshtë:

24.	Ngritja e thikave pa ngritur bigën(Free lift)	Minimumi 1400 mm	1425 mm
	Triplex Mast		
h3 4465mm / h1 2480mm / h2 1425mm			

Në Shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit dhe konkretisht i përcaktuar në dokumentin e titulluar “6 Specifikime shqip.docx” të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar parametrin teknik nr.10 si në vijim:

Ngritja e thikave pa ngritur bigën(Free lift)	Minimumi 1400 mm
---	------------------

Për shkak të specifikës së procedurës së prokurimit dhe nivelit të ekspertizës së saj, përpara vijimit me hapa të tjerë procedurale, KPP ka vendosur të thërrasë në këtë seancë dëgjimore autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues në lidhje me sqarimin e fakteve dhe rrethanave të ankesës së operatoit ekonomik dhe dëgjimit të autoriteti kontraktor. Konkretisht nga ana e Komisionit, pasi u shqyrtua ankesa e ankimuesit është konstatuar, se pretendimet që ngre operatori ekonomik janë në dokumentin me emërtimin “Katalogu_Linde_EN_ds_e35_250_1254 pdf”, të ngarkuar nga ky i fundit në sistemin e prokurimeve elektronike. Në lidhje me këto pretendime, KPP i ftoi palët në procesin administrativ me nr. 585 prot, duke zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 28.03.2025,

Komisioni iu drejtua palëve në këtë seancë nëse ka kërkesa paraprake prej tyre, dhe nuk pati asnjë kërkesë paraprake nga ana e tyre.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri.

1.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

- **Për paisjen “Lefterake Elektrike (Pirun) -Karikues per karikimin e baterive -Thika shtese me gjatesi 3500 mm- 2 copë”**

të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu_Linde_EN_ds_e35_250_1254 pdf), keni markuar specifikimet teknik të kërkuara?

Përgjigjja e OE: “Katalogu i paraqitur në SPE, është katalogu i përgjithshëm prodhuesit Linde që është i aksesueshëm për çdo njeri që hyn në internet dhe ka të dhënat kryesore standarde të Lindes të këtij lloji mjeti që është i series 1254, dhe në kollonën që është zgjedhur mjeti, është kollona në faqen nr. 3, kollona e dytë, kryesisht jepën të dhënat kryesore të mjetit që janë të mjaftueshme për të parë se çfarë plotëson ky mjet në përgjithësi. Duke qenë se asnjë mjet, asnjë pirun prodhuar nga Linde apo nga ndonjë prodhues tjetër, nuk prodhohen në seri. Të gjithë pirunat prodhohen në bazë të një kërkesë, të një urdhi porositë. Në dokumentin Katalogu_Linde_EN_ds_e35_250_1254 pdf, në faqen nr.6, me titull Mast Tables, kjo është tabela ku paraqiten disa nga llojet e kollonave që Linde ka parë të arsyeshme ti publikojë. Dhe në këtë tabelë, kjo është pjesë integrale e kollës 2 ku jepën të dhënat e mjetit dhe në atë kollonë ku jepën të dhënat e mjetit, është mbështetur autoriteti kontraktor për të bërë vlerësimin, është vendosur Mast i parë i cili nuk ka lidhje. Ajo që ne kemi ofruar është Triplex Mast, i cili nuk është te kjo tabelë, tek faqia nr. 6, pasi Linde e ka parë të arsyeshme të japi vetëm 5 lloje/modele Mast tek kjo tabelë. Dhe ka shkruar në fund që të dhëna për kollonat e tjera sipas kërkesës, e ka lënë këtë në mënyrë që të zgjidhet, kollonën mund ta konkludojë me një përfaqësues zyrtarë të Linde. Pasi Linde vetë si kompani nuk shet tek palë të treta, pasi shet nëpërmjet personave/subjektev të autorizuar. Në fund të këtij katalogu, në faqen e fundit, ky katalog përmbledhet me logon e Lindes dhe logon e “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK. Pra është një dokument zyrtar që është dërguar nga ne dhe që është edhe i Lindes. Sic është kërkuara nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekti prokurimi, ne të cilet të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, dhe në për këtë arsye kemi çuar ofertën teknike, që është dokument integral bashkë me katalogun. Kemi paraqitur edhe dokumentin tjetër që quhet specifikim teknik, ku struktura është përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe kemi dhënë komentet tona. Ne kemi paraqitur një produkt që i përmbush dhe i tejkalon kërkesat e autoritetit kontraktor dhe ky produkt është i certifikuar nga Linde.

Për sa u diskutua në këtë seancë dëgjimore, Komisioni për aq sa u deklarua, bën një përmbledhje, operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, ka dorëzuar në procedurën e prokurimit elektronik një katalog të prodhuesit Linde. Referuar deklarameteve të subjektit ankimes katalogu nuk mund të përmbajë të gjithë specifikimet e mundshme teknike, ndërkohë në katalog sipas deklarametit që iu dhatë në seancë, jepet një indicie që prodhuesi në bazë të kërkesave specifike të klientëve mund të ndërtojë mjetin në përputhje me specifikimet teknike për aq sa është e lejuar nga vetë sistemet e prodhuesit, së bashku me dokumentacionin që ju keni dorëzuar në SPE keni dorëzuar edhe një dokumentacion ku sipas deklarameteve që ju dhatë në seancë, ky katalog ose ky format datasheet është krijuar nga ana juaj në sistemin e prodhuesit, dhe ka gjeneruar mundësinë e prodhimit të këtyre mjeteve sipas këtyre specifikimeve teknike. Dhe së fundmi, ju keni dorëzuar edhe një ofertë teknike në SPE ku keni identifikuar secilin prej specifikimeve teknike në katalogun përkatës, ku ju gjykoni që këto specifikime teknike mund të përmbushen.

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: *“Si është ndjekur procedura e vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi bazën e dokumentacionit, dhe nëse autoriteti kontraktor gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka patur ndonjë rast paqartësi, dhe a ka kërkuar sqarime përkatëse nga prodhuesi, i cili ka lëshuar autoriizim prodhuesi për operatorin ekonomik për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi ose nga operatori ekonomik?”*

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Referuar kritereve të vecanta, autoriteti kontraktor në pikën 2.5 të DT “5.Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen”, qe ne te kuptojme perputhjen me specifikimet teknike qe autoriteti kontraktor ka kerkuar, do duhet qe ju te deklaroni ne ofertën teknike, katalogon duke saktësuar faqen, kollonën, nr. E serisë, nr. E modelit. Atëhere ju në SPE keni paraqitur këtë ofertë teknike. Katalogun i jeni referuar një modeli Standard Mast, pavarësisht së në faqen nr. Të katalogut ju citoni disa modele por nuk keni bërë përzgjedhjen e modelit të ofruar. Ndërkohë ajo që ju pretendoni se e përmbush specifikimet teknike është vetdeklarimi juaj, ndërkohë që unë si KVO i referohem katalogut teknik. Katalogu është dokumentacioni që prodhuesi paraqet.*

Përgjigjja e OE: *“Këto mjete sic e shpreha në fillim, nuk janë në treg dhe këto mjete prodhohen me porosi. Por mjete të këtij lloji me këto kritere nuk janë në treg dhe që të disponohet nga një prodhues i caktuar., pasi këto prodhohen të gjitha. Prandaj është dhënë edhe opsioni që ti duhet të zgjedhës këtu Triplex. Kjo oferta teknike është dokument i Lindes, pavarësisht se në si Oe kemi dhënë të dhënat e AK, linkun dhe materiali është përkthyer edhe në gjuhën shqipe, për të qënë më i kuptueshëm dhe i aksesueshëm, dhe kjo mund të demonstronet online nga ana OE.*

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: *“Për shkak se operatori ekonomik ka dorëzuar disa dokumenta në procedurën e prokurimit elektronik si katalog/skedë teknike që sipas operatorit është gjeneruar nga sistemi i prodhuesit Linde në lidhje me këtë procedurë, autoriteti juaj*

kontraktor a ka patur komunikim me prodhuesin” Komisioni i vlerësimit të oferta a ka patur paqartësitë dhe a ka kërkuara sqarime në bazë të parashikimeve të LPP dhe akteve nënligjore? A e ka pyetur prodhuesin nëse dokumentacioni i dorëzuar në Spe nga OE është i gjeneruar nga prodhuesi, pra a ka kryer KVO një vlerësim të tillë?

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Nuk është bërë asnjë komunikim me prodhuesin nga ana e KVO, pasi i jemi referuar ofertës teknike. Ndërkës këtë e kemi marrë si vet ofrim të këtyre kapaciteteve nga ana e OE.*

Pra, Komisioni gjykon se, nga ana e autoritetit kontraktor ky dokument është vlerësuar si dokument i prodhuar nga operatori ekonomik. Ndërkohë operatori ekonomik deklaron në seancë dëgjimore se ky dokument është prodhuar nga sistemi i prodhuesit për procedurën e prokurimit sipas llogarive të përdoruesit që ka operatori ekonomik në këtë sistem.

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Është vlerësuar si vetdeklarim i vet OE”.*

Për sa u diskutua në këtë seancë dëgjimore, Komisioni për aq sa u deklarua, bën një përmbledhje, autoriteti kontraktor deklaron se operatori ekonomik në ofertën teknike të dorëzuar nga ana e tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, katalog, një faqe të caktuar, një kollë të caktuar të katalogut , ku pas verifikimeve të caktuara të kryera nga ana e autoritetit kontraktor për këtë kollonë të deklarura nga ana e OE, pasi kjo kollonë nuk përmbush specifikimet teknike për disa elemente të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Ndërkohë, autoriteti kontraktor deklaron që dokumenti tjetër i dorëzuar nga ana e OE në formën e skedës teknike, ose të një dokumenti të ngjashëm me skedën teknike është vlerësuar si i prodhuar nga vetë operatori ekonomik, pra i krijuar nga vetë OE dhe jo nga prodhuesi. Dhe kjo nuk ka krijuar besueshmëri për autoritetin kontraktor, dhe i është refuzuar edhe vet deklartatë që ka bërë OE dhe katalogët që ka dorëzuar . Ndërkohë KVO deklaron se nuk ka patur nevojë për sqarime të mëtejshme me prodhuesin, sepse katalogu teknik nuk i përmbush specifikimet teknike . Ndërkohë, refuzuar operatorit ekonomik deklaron se për shkak se prodhuesi ka politikat e tij në mënyrë e hartimit të katalogut dhe jo të gjitha specifikimet teknike nuk ofertohe në katalog. Katalogu i deklaruar në ofertën teknike modelin e produktit, i cili përveç komponentë që ka në katalogun e tij, ka edhe element të tjerë që bëhen me porosi sipas kërkesave të operatorëve apo palëve në proces. Dhe ndërkohë OE deklaron se krahas kësaj ka dorëzuar edhe një dokument tjetër të prodhuar nga prodhuesi në sistemin e prodhuesit për të përmbushur specifikimet teknike.

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Në lidhje me deklaratën që është plotësuar nga vetë operatori ekonomik, për të sqaruar palët, drejtuar AK dhe KPP në një moment të dytë, ndërkohë KVO vlerëson vetëm dokumentat e ngarkuar në SPE. Dmth deklartatë ka ardhur tani, në një moment të dytë, por AK vlerëson vetëm ato që gjenden në SPE.*

Përgjigjja e OE: *“Ne si OE, na është dhënë sipas ligjit, të bëjmë ankesë dhe sqarime duke mbështetur vërtetësinë e dokumentave të ngarkuar nga ana jonë në SPE. Nuk kemi shtuar dokument, por kemi cuar një deklaratë nga prodhuesi Linde OE me përfuturën që ka dërguar*

është ajo që kërkon autoriteti kontraktor dhe ne kemi sqaruar është që oferta e dorëzuar është ajo që ju keni kërkuar.

Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë hetimit administrativ gjykoi së pari të kryente një hetim të thelluar administrativ mbi verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të hartuara nga AK me ato të dhënë në ofertën teknike të dhënë nga OE, i cili pretendon se është gjenruar nga sistemi i prodhuesit, pasi katalogu nuk mund të përmbajë të gjithë specifikimet e mundshme teknike të kërkuara, ndërkohë në katalog sipas deklaratimit që iu dhatë në seancë, jepet një indicie që prodhuesi në bazë të kërkesave specifike të klientëve mund të ndërtojë mjetin në përputhje me specifikimet teknike për aq sa është e lejuar nga vetë sistemet e prodhuesit. Në këto kushte, Komisioni nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), me shkresat me nr. 585/7 dhe nr.585/8 prot., datë 02.04.2025 iu drejtua prodhuesit LindeMaterial Handling, me kërkesën për informacion në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- 1. Dokumenti me emërtimin “5.Specifikime_Pirun_elektrik_EMC, bashkëlidhur kësaj shkrese, a është material i gjeneruar nga sistemi juaj dhe a është ekuivalent me katalogun teknik/skede teknike/fragment nga katalogu të prodhuar nga kompania juaj?*
- 2. A është kompania juaj Linde Material Handling në kushtet e përmbushjes së specifikimeve teknike të produktit të ofruar sipas dokumentit me emërtimin “5.Specifikime_Pirun_elektrik_EMC”?*

Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, email-i dërguar në adresën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në datën 03.04.2025, nga kompania “Linde Material Handling”, sipas të cilit Komisioni i Prokurimit Publik informohet se: “

Linde Material Handling GmbH | Carl-von-Linde-Platz | 63743 Aschaffenburg

To:
PUBLIC PROCUREMENT COMMISSION
CHAIRMAN Jonaid Myzyri

KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK
Blv "Dëshmorët e kombit", Sheshi "Nënë Tereza"
1010, Tiranë

Aschaffenburg, 03.04.2025

Subject: Request for information Nr. 585/8 Prot. Date 02.04.2025
Email date 2. April 2025

Dear Mr. Jonaid Myzyri,

Thank you very much for your Email.

Concerning the tender: REF-20964-09-20-2024, subject: "Purchase of Electric Lifterak Vehicles for the Car Terminal", with a budget limit of 20,000,000 (twenty million) lek (excluding VAT), developed on 11.11.2024 by the contracting authority, the Port Authority of Durrës.

I, in my capacity as Area Sales Manager – Adriatic Region, of the manufacturer Linde Material Handling GmbH, provide the following official statement on this request:

The Public Procurement Commission Request	Linde Material Handling GmbH Answer
1. Is the document titled "5.Specificime_Pirun_elektrik EMC," attached to this letter, a material generated by your system and is it equivalent to the technical catalog/technical sheet/fragment from the catalog produced by your company?	1. Yes, we can confirm that this document, issued by the contracting authority was filled out by EMC, our official dealer, in full compliance with our system generated truck configuration software. Please see also the document submitted to the tender titled: OFERTA_APD_REF-20964-09-20-2024 enclosed to this Letter, which is generated from our internal software.
2. Is your company, Linde Material Handling, in compliance with the technical specifications of the offered product according to the document titled "5.Specificime_Pirun_elektrik EMC"?	2. Yes, our company Linde Material Handling GmbH, confirms that the technical specifications of the offered product according to the document titled "5.Specificime_Pirun_elektrik EMC" fully comply with our production specifications.

The Forklifts offered in this Tender will be produced and equipped from Linde Material Handling GmbH with the following Mast:

TRIPLEX MAST 1534
Lift height 4465mm
Mast Height 2480mm
Free lift 1425mm

KOLLONE TRIPLEX 1534
Lartesia ngritese 4465mm
Lartesia e kollones e mbyllur 2480mm
Free lift 1425mm

We hereby declare that the offer submitted the EMC is based on our internal system options, in this case customizable Mast options (please see the 3rd line) as follows:

3400 - TRIPLEX MAST 1534

Series 1534

30 / 31 / 32

3400 - 3030

3770mm / 2370mm / 1225mm

3400 - 3030

4070mm / 2430mm / 1225mm

3400 - 3030

4460mm / 2480mm / 1425mm

3400 - 3110

4670mm / 2530mm / 1475mm

3400 - 3110

4785mm / 2580mm / 1525mm

3400 - 3130

5060mm / 2680mm / 1625mm

3400 - 3170

5270mm / 2730mm / 1675mm

3400 - 3220

5660mm / 2880mm / 1825mm

3400 - 3220

5715mm / 2930mm / 1875mm

3400 - 3280

6075mm / 3030mm / 1975mm

3400 - 3280

6485mm / 3180mm / 2125mm

3400 - 3300

7395mm / 3480mm / 2425mm



All of those above available mast options are official customized solutions and regular part of our forklift production process. All of our trucks are produced by latest standards and are delivered with relevant CE certification, stating conformity with Supply of Machinery Safety Regulations 2008, 2008 No. 1597 and to Electromagnetic Compatibility Regulations 2016, 2016 No. 1091 as determined for industrial trucks in the designated standard EN 12895:2015+A1:2019.

If you need additional explanation, please let us know.

Best regards,

Tihomir Čuić

Area Sales Manager – Adriatic Region

Linde Material Handling GmbH

Duke marrë shkas nga kthim-përgjigjja e sipërcituar, administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, për arsye se siç njofton vetë shoqëria prodhuese “Linde Material Handling”, ku kjo e fundit është prodhuese e artikujve objekt shqyrtim ankimi, konfirmon se *specifikimet teknike të produktit të ofruar, sipas dokumentit të titulluar, përputhen plotësisht me specifikimet tona të prodhimit*, me të cilin operatori ekonomik ankimes ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, prodhuesi Linde Material Handling konfirmon se oferrat teknike “OFERTA_APD_REF-20964-09-20-2024.pdf”, e dhënë për autoriteti kontraktor nga përfaqësuesi i tyr zyrtar në Shqipëri “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, është gjeneruar nga sistemi i tyre i brendshëm. Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe informacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit, si dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 28.03.2025 në mjediset e KPP-së, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik, “EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER” SHPK, si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtar i njësisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, i cili ka qenë pjesë e

grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, rezultoni, se në përfundim të këtij seksioni në lidhje me sa u deklarua më lart, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi të subjektit “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK, u sqaruan në mënyrë shteruese mbi paqartësitë dhe u saktësuan mbi përmbushjen e specifikimeve teknike për artikujt e sipërcituar. Në fund të seancës dëgjimore, Komisioni iu drejtua palëve të pranishme, nëse kishin pretendime apo kërkesa dhe nuk kishte.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me nr. REF-20964-09-20-2024, me objekt: “*Blerje Lifterake elektrike për Terminalin e Autove*”, me fond limit 20.000.000 (njëzet milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*EMC ENGINEERING MAINTENANCE CENTER*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
Kryetar			
Jonaïd Myzyri			

